



KONTRATA SOCIALE FIER

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

SHTATOR 2022-SHTATOR 2023

Viti i IV i monitorimit

**PËRGATITUR NGA:
QENDRA "EPOKA E RE"**



Gender Alliance for Development Center
Qendra Albanica Gjimore për Zhvillim



Tabela e Përmbajtjes

SHKURTIME	3
FALENDERIME	4
HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	11
GJETJET	11
KONTRATA SOCIALE	14
KËSHILLI BASHKIAK FIER	15
MBLEDHJET E KËSHILLIT TË BASHKISË FIER	16
GJETJE NGA BASHKIA FIER	17
GJETJE NGA KOMUNITETI.....	26
PROGRESI I KONTRATËS SOCIALE	33
ANALIZA E PRIORITETEVE	34
PRIORITET 1: TRANSPARENCA	34
PRIORITET 2 : INFRASTRUKTURA	35
PRIORITET 3: SHËRBIMET SOCIALE	37
PRIORITET 4: VËMENDJE NDAJ TË RINJVE	38
PRIORITET 5: VËMENDJE NDAJ FËMIJËVE.....	39
REKOMANDIME	41
ANEKSE	43
ANEKSI 1 - REFERENCAT	43
AN EKSI 2 – FOTO	44
ANEKSI 3 – KONTRATA	55

Shkurtime

<i>BF</i>	<i>Bashkia Fier</i>
<i>QV</i>	<i>Qeverisje Vendore</i>
<i>NJA</i>	<i>Njësi Administrative</i>
<i>KBF</i>	<i>Këshilli Bashkiak Fier</i>
<i>VKB</i>	<i>Vendimi Këshillit Bashkiak</i>
<i>VKM</i>	<i>Vendim i Këshillit të Ministratave</i>
<i>URB</i>	<i>Zonat Urbane</i>
<i>RUR</i>	<i>Zonat Rurale</i>
<i>PAK</i>	<i>Personat me aftësi të kufizuar</i>
<i>ZK</i>	<i>Zonë Kadastrale</i>
<i>PBA</i>	<i>Buxheti Afat-Mesëm</i>
<i>PVMIM</i>	<i>Plani Vendori Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve</i>
<i>OSHC</i>	<i>Organizata e Shoqërisë Civile</i>
<i>KVR</i>	<i>Këshilli Vendor Rinor</i>
<i>KOKSH</i>	<i>Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar</i>
<i>POP</i>	<i>Përballja e Ofertave Politike</i>
<i>Kontrata Sociale¹</i>	<i>Me prioritetet të përzgjedhura nga komuniteti në vitin 2019</i>
<i>COVID-19</i>	<i>Koronavirusi Sars–kovid</i>

3

¹<https://popnetwork.al/fier-kontrata-sociale/>

Falenderime

Firmosja e kontratës sociale 2019, dokumenti që na lidhi ngushtësisht me nevojat dhe intereset e qytetarëve, i hapi rrugë angazhimit dhe përpjekjeve të vazhdueshme për 4 vite me radhë për të kontribuar për një qytet më të mirë. Në këtë rrugëtim të gjatë e impenjativ, ku mbi të gjitha shumë i rëndësishëm ka qenë bashkëpunimi me qeverisjen vendore, qytetarët, të rinjtë vullnetarë të Qendrës “Epoka e Re”, rrjetin POP dhe aktorë të tjerë lokal, asnjë rezultat nuk do të kishte nëse do të mungonte mbështetja dhe dhe prezenca e tyre.

Faleminderit të gjithëve!

Falenderim për të gjithë këta bashkëpunëtorë strategjik, të cilët shtynë përpara jo vetëm progresin e përmbushjes së prioritetëve të kësaj kontrate, por edhe zhvillimin cilësor të vendit, duke treguar njëkohësisht ndjenjën e fortë të qytetarisë dhe përgjesisë individuale e institucionale.

E rëndësishme dhe madje shumë, është dhe mirënjohja për rrjetin POP, i cili na krijoi mundësinë të kishim një zë më të fortë dhe depërtues në qeverisjen vendore, duke nxitur një qeverisje më të mirë, të forconim lidhjen me komunitetin dhe të rrisim vetbesimin e tyre në lidhje me forcën ndikuese që ata kanë mbi vendimmarrësit.

Falenderim të veçantë për *Olof Palme International center* dhe *NED –National Endowment for Democracy* për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP².

²<https://popnetwork.al/rreth-projektit/>

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2021-2022 për të tretin vit me rradhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Ky është viti i tretë i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale.

Kontrata Sociale në Fier³ përmban 5 prioritete që qytetarët e Fierit identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Qendra “Epoka e Re”, synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetarë në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. Qendra Epoka e Re mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Fier, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin e Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre.

Faza e parë e kësaj nisme konsistonte në konsolidimin e saj me Qeverisjen vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale⁴, deklarimin publik të saj me aktorët kryesorë vendorë. Kjo periudhë përfshin procesin e monitorimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, të zbatimit të prioriteteve të kontratës sociale, të forcimit të marrëdhënieve midis qytetarëve, POP dhe aktorëve të tjerë në shoqëri. Pjesë e rëndësishme e saj ishte raportimi dhe veshja me përgjegjësi e drejtuesve në nivelin lokal për të përmbushur kontratën sociale.

Raporti i vitit të parë⁵ monitorues dhe raporti i vitit të dytë⁶ dhe raportit të tretë⁷ monitorues janë ndarë gjerësisht me përfaqësues të bashkisë Fier si edhe me qytetarët duke analizuar arritjet, por edhe punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioriteteve që janë adresuar pak, ose aspak dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor.

³<https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2019/06/POP-2019-Fier-Kontrata-Sociale.pdf>

⁴https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/11/Raporti_POP_Bashkia_Fier.pdf

⁵<https://popnetwork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-fier/>

⁶https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/01/Raporti-POP_Bashkia-Fier.pdf

⁷<https://popnetwork.al/fier-raporti-i-trete-monitorues-i-kontrates-sociale-shtator-2021-shtator-2022/>

Për të mbërritur në vitin e tretë të monitorimit⁸, gjatë vitit 2022 dhe 2023, projekti vazhdoi me monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale duke dhënë një panoramë të përgjithshme të ecurisë së këtij progresi nga momenti i firmosjes deri në përfundim të afatit qeverisës (2019 – 2023).

- *Analizë 4 vjeçare e progresit të monitorimit të zbatueshmërisë së Kontratës Sociale dhe përmbushjes së prioriteteve të saj.*

Gjatë kohështrirjes së Kontratës Sociale 2019 - 2023, Organizata kishte si qëllim:


- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, kryesisht në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.
- Të organizojë dhe angazhojë grupet qytetare në fushata advokim – lobimi, me qëllim përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë Fier për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale.
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë.
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet.
- Të përdorë gjetjet e Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”⁹ për angazhimin dhe informimin e qytetarëve.
- Të nxisë fuqizimin e KVR-së dhe angazhimin rinor e qytetar.
- Të faktorizojë zërin e të rinjve në projektet vendore.

⁸<https://popnetwork.al/category/aktivitete-fier/>


⁹<https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/07/Raporti-Studimor-Bashkia-Fier-2022.pdf>

Metodologjia

Ky raport është bazuar në rezultatet e punës 4 vjeçare që organizata ka bërë nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate mes vendimmarrësve dhe qytetarëve. Metodologjia e përdorur është po ajo e zbatueshmërisë së projektit:



- U monitorua në mënyrë sistematike puna e Bashkisë Fier dhe e Këshillit Bashkiak.
- U monitoruan vendimmarrja e Këshillit Bashkiak dhe mbledhjet e organizuara.
- U monitoruan vendimet e Këshillit të Bashkisë Fier dhe zbatueshmëria e atyre vendimeve që ndikonin në përmbushjen e prioriteteve të KS-së.
- U monitoruan dhe u analizuan vendimet e KBF-së që kanë lidhje me prioritetet e KS-së bazuar në punën e rrjetit POP, apo edhe faktorë të tjerë të jashtëm, të tipit:
 - a) Parashikime të mëhershme në buxhet.
 - b) Plane afatshkurtra apo/dhe afatgjata.
 - c) Ndikime të tjera (organizata qeveritare, organizata ndërkombëtare me projekte apo edhe kombëtare).
- U analizuan dhe monitoruan në mënyrë periodike buxhetet vjetore të Bashkisë Fier përgjatë gjithë periudhës 2019 – 2023, buxhetet afatmesme si dhe shpenzimet respektive bazuar në open-data.
- U organizuan takime me përfaqësues të Qeverisjes Vendore dhe me qytetarë të Fierit, mbi ecurinë e punës sa i përket përmbushjes së prioriteteve të komunitetit.
- U realizuan fokus-grupe me grupe interesi, të cilët kanë qenë aktiv në aktivitetet e mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale, si edhe në monitorimin e saj gjatë viteve.
- U informuan dhe u organizuan qytetarët dhe të rinjtë drejt një pjesëmarrje aktive në vendimmarrje.



Monitorimi

Monitorimi ka qenë pjesë e rëndësishme e projektit POP. I gjithë procesi, që nga momenti i firmosjes së KS-së deri në momentin e përfundimit të afatit të vlefshmërisë së saj (2019 – 2023) ka qenë nën monitorim nga organizata.

■ Takimet kanë qenë të vazhdueshme.

- ✓ Janë zhvilluar takime në grupe të vogla, ku është diskutuar ecuria e progresit të përmbushjeve të prioriteteve të kontratës, si dhe problematikat e tjera të hasura gjatë këtij procesi.
- ✓ Janë zhvilluar takime edhe individuale me përfaqësues të lartë të BF-së, të cilët kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në prioritizimin e punëve institucionale.
- ✓ Pjesë e rëndësishme e këtyre takimeve ka qenë edhe marrja e informacioneve permanente mbi këtë ecuri, si dhe arsyet penguese të mos adresimit të çështjeve respektive në kohë.

8

■ Fokus grupe

Fokus grupe

Fokus grupe me komunitetin dhe grupet e interesit për të marrë një mendim më të strukturuar dhe të qartë, gati për procesin e lobimit. Ky proces na ka siguruar edhe ngritjen e një bërthame qytetarësh aktiv.

- ✓ Paralel me këto takime janë zhvilluar edhe fokus grupe me qytetarë dhe grupe interesi që lidhen direkt ose indirekt me prioritetet të KS-së.
- ✓ Puna e marrjes së mendimit të komunitetit mbi ecurinë e përmbushjes së dakordësisë së kësaj kontrate është parë më e frytshme duke e klasifikuar atë në marrjen e një kampioni për çdo përfaqësim si: të rinjtë, gratë, komuniteti në zonat rurale dhe urbane, intelektualët, gazetarët etj.

■ Monitorimi u përqendrua në:

- ✓ Monitorim permanent i mbledhjeve të KBF-së.
- ✓ Monitorim i faqes zyrtare të BF-së <http://bashkiafier.gov.al/>.
- ✓ Monitorim i rrjeteve sociale të këtij institucioni FB-
<https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>.
- ✓ Monitorim faktik për çdo prioritet, i cili është realizuar gjithmonë përgjatë periudhës së grumbullimit të mendimit qytetar.
- ✓ Monitorim i hartimit dhe implementimit të buxhetit vjetër, paketës Fiskale, PBA-së, etj.
- ✓ Monitorim dhe analizim i mediave audio – vizive dhe on line, sipas fushave specifike. Sjellja dhe qasja e tyre.
- ✓ Monitorim dhe analizë e detajuar e buxhetit mbi eurinë buxheture të realizimit të KS-së 2019 – 2023.

- Është punuar fort edhe në aspektin formues të të rinjve, nxitës dhe lobues:
 - ✓ Organizim i të rinjve në nisma të ndryshme ndikuese në jetën aktive në nivel lokal.
 - ✓ Rritje e mundësisë për të qenë aktiv në jetën sociale, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme e të larmishme.
 - ✓ Lobim dhe sukses i arritur me ngritjen dhe forcimin e strukturës rinore pranë Bashkisë, Këshilli Vendor Rinor.
 - ✓ Faktorizim në vendimmarrjen lokale të të rinjve, nëpërmjet KVR-së.
 - ✓ Lehtësim i proceseve për informim.
 - ✓ Aftësim, organizim dhe nxitje të të rinjve për të qenë ideatorë dhe hartues të disa projekteve me ndikim në jetën e tyre dhe në komunitet.
 - ✓ Fasilitim në hartimin e projekteve nga të rinjtë dhe në krijimin e mundësisë për t'i prezantuar përpara komisionit të ngritur nga BF, me qëllim sigurimin financiar.
 - ✓ Mbështetje e të rinjve në procesin e lobimit pranë bashkisë për financimin e projekteve.

9

Lobimi

*Pa lobim asnjë
përpjekje nuk do të
rezultonte e
suksesshme dhe
rezultati i progresit të
kësaj kontrate është
dëshmia më e mirë e
vlerës së lobimit që
Epoka e Re ka bërë në
këto 4 vite.*

POP, një instrument Organizimi – Pjesëmarrjeje – Ndikimi komunitar

Qendra Epoka e Re, në këto 4 vite është përpjekur fort të krijojë në komunitet dhe habitatin e zbatim-projektit një ambient miqësor

dhe të aksesueshëm

për të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e qeverisjes vendore të cilët të kishin mundësi të depërtonin në brendësi të POP, për të garantuar përmbushjen e objektivave. Krahas objektivit të projektit POP, Epoka e Re është fokusuar edhe në realizimin e objektivave specifike si:

- **Rritja e ndikimit qytetar në vendimmarrjen lokale**, nëpërmjet depërtimit të organizatës së komunitet me aktivitete të ndryshme informuese.
- **Fuqizim i zërit të qytetarëve dhe OSHC-ve** me qëllim monitorimin e punës institucionale dhe advokimin pranë qeverisjes vendore për zbatimin e kornizës ligjore, si dhe përmbushjen e prioritetëve të kontratës sociale.
- **Forcimi i rrjetit POP** nëpërmjet bashkëpunimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme, për ta shtrirë impaktin edhe në bashki të tjera, jashtë territorit të veprimtarisë.
- **Forcimi i marrëdhënies qytetarë – POP – aktorë të tjerë**, e cila ka qenë një përpjekje e vazhdueshme nëpërmjet takimeve të shumta konsultative, formale dhe informale, për të rritur sa më shumë prezencën e organizatës dhe vet rrjetit POP në komunitet.
- **Puna nxitëse permanente ndaj përfaqësuesve të qeverisjes vendore** për detyrimin e tyre në përmbushjen e plotë të kërkesave në kontratën sociale.
- **Disponibiliteti i organizatës për fasilitim** të nismave të ndryshme komunitare apo institucionale që i shërbejnë qytetarëve.
- **Nxitja e transparencës** në shërbim të qytetareve, por dhe vet institucionit, duke i hapur rrugë krijimit të një raporti më miqësor e të afërt mes qytetarëve dhe institucionit.

Në këtë 4 vjeçar është punuar ngushtësisht me Bashkinë Fier, Këshillin e Bashkisë Fier, Kryetarin e Bashkisë Fier, Kryetarin e Këshillit Bashkiak Fier, Median, Organizatat e Shoqërisë Civile, intelektualët, të rinjtë, gratë, qytetarët.

10



Përmbledhje Ekzekutive


Rritja e ndikimit të qytetarëve, të rinjve, grupeve të interesit dhe forcimi i marrëdhënieve mes tyre dhe qeverisjes në nivel vendor, duke përdorur si mekanizëm bashkëpunimin, përmbushjen e

kontratës sociale, ka

qenë fokusi i punës së projektit POP gjatë këtyre 4 viteve në Bashkinë Fier. Kanë qenë një sërë veprimesh, angazhimesh dhe rezultatesh përgjatë këtyre viteve, por disa prej tyre që lënë gjurmë edhe në ecurinë e mëtejshme të veprimtarisë së projektit dhe rrjetit POP janë:

- ❖ Ndikim në vendimmarrjen lokale nëpërmjet zërit të të rinjve, duke garantuar financimin e disa prej projekteve dhe kërkesave të tyre.
- ❖ Ngritje, formalizim dhe fuqizim i Këshillit Vendor Rinor¹⁰, një zë përfaqësues i të rinjve dhe komunitetit.
- ❖ Rritje e ndërgjegjes qytetare për forcës ndikuese të tyre në vendimmarrjen lokale.
- ❖ Formësim, informim dhe mentorim i të rinjve në nisma komunitare.
- ❖ Ndikim më i madh i të rinjve dhe Qendrës Epoka e Re në proceset ndërvepruese të qeverisjes vendore, duke forcuar komunikimin dhe zërin e të rinjve edhe në proceset vendimmarrëse.
- ❖ Monitorim i vazhdueshëm i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, me një qasje të re të frekuentueshmërisë së tij nga të rinj të ndryshëm jo të organizuar.
- ❖ Bashkëpunim, koordinim dhe ndërveprim mes Epokës së Re, të rinjve dhe qeverisjes vendore, duke nxitur forcimin e marrëdhënieve mes tyre.
- ❖ Monitorim i punës së qeverisjes vendore në të gjithë territorin e bashkisë, për të ndjekur ecurinë e progresit të kontratës sociale.
- ❖ Frekuentim permanent me efekt ndikues në takime, organizime dhe konsultime publike që BF^{ja} ka iniciuar gjatë këtyre 4 viteve, duke luajtur një rol aktiv në pjesëmarrje dhe nxitje të prezencës qytetare në to, me qëllim rritjen e ndërveprimit mes trinomit: Qytetarë – OSHC – Qeverisje Vendore.
- ❖ Nxitje takimesh dhe organizimesh mes qytetareve, të rinjve dhe përfaqësuesve të qeverisjes vendore (nga ana e Qendrës Epoka e Re), në funksion të transparencës dhe përgjegjësisë institucionale për një qeverisje më të mirë.
- ❖ Lobim dhe rezultat nëpërmjet nxitjes së të rinjve për pjesëmarrje dhe angazhim.
- ❖ Rikthimi i frymës bashkëpunuese dhe vepruese institucionale nëpërmjet prezencës dhe ndikimit qytetar.

11



Gjetjet

¹⁰<https://ms-my.facebook.com/104337948185698/photos/a.136619568290869/323296679623156/?type=3>

• Përgjatë viteve 2019

– 2023, Këshilli Bashkiak Fier ka marrë 485 vendime, 297 prej të cilave kanë ndikim direkt ose indirekt në përmbushjen e pikave të kontratës sociale 2019.




Figure 1: Vendimet e KBF

- Fundviti i 2019-ës solli një devijim të lehtë të vendimmarrjes dhe fokusit të punës së BF^{së}. Tërmeti i 26 nëntorit orientoi vendimmarrjen në sigurimin e ndihmave dhe gjetjen e mbështetjes financiare për familjet e prekura.
- Viti 2020 nisi me një tjetër goditje të fortë. Shfaqja e pandemisë COVID -19 solli një ndryshim rrënjësor në funksionimin e qeverisjes vendore ashtu sikurse në jetën e të gjithëve.
 - a) Mbledhjet e KB^{së} filluan të zhvilloheshin online dhe kjo gjë vijoi deri në mesin e vitit 2021.
 - b) Prezenca e qytetarëve në sportelet dhe dyert e institucionit ishte pothuajse zero.
 - c) Kontaktet me qytetarët humbën.
 - d) U forcua një mjet tjetër komunikimi, ai online.
 - e) U fuqizuan rrjetet sociale dhe komunikimet formale.
 - f) Media rriti ndikimin e saj me prezencën në terren.
 - g) Media rriti prezencën edhe në kërkimin e informacioneve në rrugë institucionale për të luajtur rolin e avokatit të qytetarëve, të cilët kanë të drejtën për informim edhe kur nuk kanë mundësi ta marrin atë.
 - h) Gjatë periudhës 2020 – 2021, mbi 80% e kërkesave për informacion në Bashkinë Fier janë depozituar nga gazetarët dhe përfaqësuesit e medias.
- Gjatë këtyre viteve, Bashkia Fier ka përdorur, por edhe ka testuar mënyrat më efikase të dhënies dhe shpërndarjes së informacionit: online, shpallje në vende me akses të gjerë dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë.
- Duke ardhur dhe duke filtruar rrugët më efikase të komunikimit me qytetarët, BF^{ja} ka nxitur atë online duke qenë se është edhe më e përdorshme nga punliku.
- Për njoftimet e qytetarëve dhe grupeve të interesit, BF^{ja} përdor në mënyrë të vazhdueshme: informacionet dhe njoftimet online në rrjetet sociale, si edhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë nëpërmjet kryepleqve të fshatrave, administratorëve, apo individëve influentë.

• Kanalet online të

komunikimit të BF^{-së} për informimin e publikut janë: Faqja zyrtare e bashkisë (WEB)¹¹ dhe llogaria në rretin social FB¹².

- Pas periudhës së ngrirjes së kontakteve dhe komunikimeve të qytetarëve me institucionin e bashkisë, nga viti 2021 e në vazhdim, në mënyrë graduale u rikthye prezenca e qytetarëve në sportelet e institucionit, duke rikthyer njëkohësisht edhe interesin për kërkimin e informacioneve, dhënien e ankesave, pa hequr dorë nga procesi online nëpërmjet: adresës zyrtare të bashkisë¹³; me shkresë nëpërmjet zyrës me një ndalesë (nëpërmjet koordinаторit të informimit); me postë, në kutinë postare (inbox) të FB^{-së} së bashkisë.
- U formalizua rregullorja e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje, e cila detyron prezencën e anëtarëve të KB^{-së}, duke i dhënë edhe më shumë rëndësi këtij procesi gjithëpërfshirës.
- Pas formalizimit të rregullores së KBF^{-së} për procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje, nga viti 2022 e në vazhdim ka qenë e dukshme prezenca e anëtarëve të KBF^{-së} në konsultimet publike për: “Buxhetin Vjetor”, “Paketën Fiskale” dhe “PBA^{-në}”.
- Është rritur interesi i të rinjve aktiv në proceset vendimmarrëse.
- Të rinjtë nxitës e inkurajues në procese monitorimi dhe advokimi në përmbushje të KS^{-së}.
- Qendra Epoka e Re ka bërë një lobim të vazhdueshëm dhe ka krijuar të gjitha facilitet e nevojshme për ngritjen, formalizimin dhe fuqizimin e KVR^{-së} në Bashkinë Fier.
- KVR ka rritur ndikimin e të rinjve dhe qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe në jetën aktive.
- Qendra Epoka e Re ka luajtur rol thelbësor në informimin, formësimin, orientimin e të rinjve për hartimin e një sërë projektsh iniciuar nga të rinjtë dhe lobuar në Bashkinë Fier për mbështetje financiare.
- Pas një pune të gjatë infrastrukturore dhe strukturore, janë vënë në funksion terrenet sportive pranë ETC^{-së}, të cilat aktualisht shërbejnë për të gjitha aktivitetet sportive të ngrupmoshave të ndryshme. Në këto ambiente zhvillohen edhe kampionate për çdo disiplinë në nivel lokal dhe rajonal.
- Një nga prioritetet e KS^{-së} mbetet ende sfidë për BF^{-në} për shkak të mungesës së financimit të nevojshëm: Ngrita e një qendre pritëse psiko – sociale për gratë e dhunuara dhe fëmijët. BF^{-ja} prej vitesh ka gati projektin, si edhe alternativat për vendin e ngritjes së kësaj qendre, por ende nuk ka arritur të sigurojë mbështetjen finansiare edhe në formën e bashkëfinancimit. Ajo është e gatshme të vërë në dispozicion godinën dhe stafin funksional për mbarëvajtjen e saj.
- Buxheti për rininë është tashmë pjesë e një zëri të ndarë në buxhetin vjetor të Bashkisë Fier. Funksionet e Drejtorisë për Rininë, aktivitetet dhe koordinimin në Bashkinë Fier i kryen Qendra e Aktiviteteve Kulturore, ku realizohen të gjitha aktivitetet dhe projektet për të rinjtë e fëmijët.
- QAK^{-ja} ka rritur ndikimin e saj në jetën e të rinjve dhe fëmijëve duke siguruar një frekuentim të kënaqshëm me rritje vit pas viti, nëpërmjet aktivitetit të saj permanent në sektorët: kërcim modern, valle popullore, letërsi, gazetari, art pamor, sporte, qëndistari etj.

¹¹<http://bashkiafier.gov.al/>

¹²<https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>

¹³info@bashkiafier.gov.al

Kontrata Sociale

Nisma e rrjetit POP synon të rrisë debatin publik dhe informacionin tek qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Për të arritur këtë qëllim është hartuar Kontrata Sociale për të gjitha bashkitë, ku organizatat e rrjetit operojnë, e cila është firmosur nga Kryetari I Bashkisë. Kontrata Sociale është një dokument I hartuar me prioritetet e qytetarëve nga takime, focus grupe dhe forume të organizuara gjatë periudhës parazgjedhore 2019.

Prioritetet e komunitetit bazohen në katër shtylla kryesore:

- Shërbimet Publike
- Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja
- Zhvillimi Ekonomik Vendor
- Dimensioni Social në Nivel Vendor

Kontratat Sociale nuk janë thjesht një premtim i shkruar, por një angazhim për kryetarët e zgjedhur për të përmbushur këto prioritete Brenda katërvjeçarit të mandatit të tyre.

Kontrata sociale e Bashkisë Fier u formalizua më 17 tetor 2019, me dakortësimin/firmosjen e saj nga: Kryetari i Bashkisë Fier Z. Armando Subashi, Kryetari i Këshillit Bashkiak Fier Z. Vangjel Ndreko dhe Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës Epoka e Re Fier, Znj. Nevila Jahaj¹⁴.



14


Nëpërmjet kësaj kontrate, Bashkia dhe Këshilli Bashkiak angazhohen në realizimin e disa çështjeve që për komunitetin dhe kryesisht për të rinjtë janë prioritare. Kjo kontratë u firmos gjatë një Forumi Publik me pjesëmarrjen e të rinjve, shoqërisë civile, grupeve të interesit, qytetarëve e Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Fier.

Puna për përgatitjen e saj nisi muaj më parë. Përpara përpilimit të kësaj kontrate sociale u arrit grumbullimi i mendimit dhe prioriteteve të qytetarëve, të rinjve. U realizuan disa fokus grupe dhe u studiua e gjithë situata në territorin e Bashkisë Fier, shpërndarë në problematika e shërbime reale, marrëdhëniet e ndërveprimet komunitet, të rinj, qeverisje vendore etj.

Informacioni dhe rezultatet e grumbulluara nga këto zhvillime, u selektuan në bazë prioritetesh, nga të cilat u zgjodhën ato më të rëndësishme dhe emergjente të cilat ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre nëpërmjet procesit fokus grup, po nga të rinjtë e komuniteti.

Prioritetet e përzgjedhura janë të shtrira në 5 shtylla kryesore:

¹⁴<https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2019/06/POP-2019-Fier-Kontrata-Sociale.pdf>



Këshilli i Bashkisë Fier

Këshilli i Bashkisë Fier, me një mandat 4 vjeçar u konstituua më 27 korrik 2019. Mbledhja e tij e parë pas konstituimit është zhvilluar më 10 shtator 2019. KBF^{ja} përbëhet nga 51 anëtarë. Përgjatë këtij 4 vjeçari ka munguar përfaqësimi opozitar për shkak të bojkotit të zgjedhjeve. Mbështetur në pikën a) të nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, si dhe në Rregulloren e Funkionimit të Këshillit të Bashkisë Fier, miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 63 datë 04.09.2007, kapitulli IX neni 35, KBF^{ja} në mbledhjen e datës 07.10.2019 vendosi krijimin e 12 komisioneve të përhershme.


Komisionet e përhershme¹⁵:

- Komisioni i Ekonomisë, Financës dhe Privatizimeve
- Komisioni Juridik dhe i çështjeve Instrukionale
- Komisioni për Punët Publike dhe Emergjencat
- Komisioni i Çështjeve Sociale
- Komisioni për Çështjet e Zhvillimit Urban, Planifikimit të Territorit Mjedisit dhe Shëndetit Publik
- Komisioni i Arsimit, Kulturës, Sportit dhe I Marrëdhënieve me jashtë

¹⁵<http://bashkiafier.gov.al/>

• Komisioni i Auditit

- Komisioni i Votimit
- Komisioni për Mbikqyrjen, Kontrollin dhe Nënshkrimin e Proces – Verbaleve të Mbledhjes
- Komisioni për Zhvillimet Bujqësore, Blegtorile dhe të Agrobiznesit.
- Komisioni për Barazinë Gjinore
- Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për Shpalljen ose Njohjen e Statusit të "Dëshmorëve të Atdheut".



Mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Fier

Përgjatë viteve 2019 – 2023 KBF^{ja} ka ruajtur pothuajse të njëjtin tred tipologjik të vendimmarrjes së saj. Ky është një konstatim i evidentuar gjatë gjithë procesit të monitorimit të mbledhjeve të KBF^{së}, një nga elementët kryesor të projektit POP.

Figure 2: Komisionet e përhershme

Gjatë periudhës shtator 2019 – mars 2023, Këshilli Bashkiak Fier ka marrë 485 vendime, 297 prej të cilave kanë ndikim direkt ose indirekt në përmbushjen e pikave të kontratës sociale 2019.


• Fundviti 2019 dhe 6

mujori I pare i vitit 2020 kanë qenë totalisht të dedikuara kujdesit social, ndihmave për tërmetin, ndihma për të moshuarit përgjatë pandemisë, mbështetje e familjeve në nevojë etj.

- Nga 6 mujori i dytë i vitit 2020 nisi të rikthehet, edhe pse me ngadalë normaliteti edhe në tipologjinë e vendimmarrjes.
- Përgjatë vitit 2020 të gjitha mbledhjet e KBF^{së} zhvilloheshin online në platformën Skype. Në vitin 2021 mbledhjet e KBF^{së} rikthehen në sallë në masa mbrojtëse anti-covid, por ekzistonin edhe rastet e praktikës online.

Harta e tipologjisë së vendimeve

- Karakter social
- Karakter ekonomik
- Karakter procedural
- Infrastrukturalë/projekte prioritare
- Të tjera



Duke përjashtuar fundvitin 2019 të tërmetit të 26 nëntorit dhe vitit 2020 dedikuar luftës kundër covid-it, pothuajse gjatë gjithë viteve të tjera tipologjia e vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë pothuajse ka qenë me të njëjtin orientim. Përgjithësisht vendimet kanë ruajtur të njëjtin trend karakterial: social/ekonomik, zhvillim infrastrukturor, procedural, vlerësues të figurave të ndryshme publike, etj.

Figure 3: Karakteri i vendimeve të KBF

Nga monitorimi i vendimeve të KBF^{së} ¹⁶, orientimi i ekzekutivit, dhe

vendimmarrja në kohë dhe hapësirë kanë qenë të pritura në përshkallëzim nga lart poshtë në këtë mënyrë:

- ✓ 30% e vendimeve, ku pjesa më e madhe ka qenë e fokusuar në vitet e pandemisë, janë me karakter social, që lidhen me mbështetjen financiare për familjet në nevojë, të pastreha, ndihmë të menjëhershme në rast sëmundjeje, ndihmë për fëmijë jetim, përfshirje në shtëpinë e të moshuarve, mbrojtje civile etj.
- ✓ 23% e vendimeve janë me karakter ekonomik.
- ✓ 23% e vendimeve kanë karakter zhvillimor. Ato kanë të bëjnë me zhvillimin e projekteve prioritare. Këtu përfshihen edhe investimet që janë bërë në institucionet arsimore, terrene sportive.
- ✓ 22% e vendimeve janë me karakter procedural që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës së ekzekutivit, shërbimet e ndryshme, apo procedura të ndërveprimeve instucionale në nivel vendor sic është ASHK^{-ja}.

¹⁶<https://www.vendime.al/fier/>

✓ 2% e

vendimeve kanë karaktere të ndryshme dhe lidhen me vlerësimin e figurave publike, emërtiminin e rrugëve, shkollave, institucioneve etj.

Gjetje nga Bashkia Fier

Përgjatë zhvillimit të projektit POP, gjithmonë ka ekzistuar një komunikim i vazhdueshëm dhe korrekt me Bashkinë Fier jo vetëm në lidhje me ecurinë e punës për përmbushjen e prioriteteve të kontratës sociale, por edhe për çdo problematikë që adresohet nga komuniteti nëpërmjet të rinjve dhe qendrës Epoka e Re. Ka ekzistuar një vullnet i ndërsjelltë që ka sjellë progres kryesisht në prezencën e qytetarëve në forume dhe procese vendimmarrëse. Informacionet nga Bashkia Fier janë marrë nëpërmjet shkresave zyrtare dërguar në emër të projektit POP dhe nëpërmjet takimeve të drejtëpërdrejta me përfaqësuesit e drejtorive respektive që lidhen me ecurinë e progresit të kontratës sociale.

Të gjitha këto informacione janë shkruar sa më poshtë vijon, në formën e mendimit, vizionit institucional dhe shpërndarjes së tyre në prioritetet e Kontratës Sociale.

18

Nëpërmjet planeve afatgjata, BF synon të garantojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, si dhe një jetë cilësore për qytetarët e saj. Një plan afatgjatë vizionar, nuk mund të jetë i tillë, nëse nuk kombinon në mënyrë të integruar zhvillimin urban, turizmin, bujqësinë, barazinë sociale, shërbimet, proceset e konsolidimit dhe zhvillimit të pronës, organizimin e mobilitetit dhe të rrjetit të transportit, si dhe aspekte të tjera që ndërthuren mbi konceptin e zhvillimit të territorit. Për të realizuar këtë integrim sektorial në territor, bashkia u përfshi në një proces intensiv të analizës dhe mendimit strategjik, që jo vetëm shtron shinat për planin, por i jep mundësi institucionit të konceptojë projekte prioritare e që reflektojnë më së miri dinamikën e zhvillimit urban në Fier. Vizioni i zhvillimit të territorit për Bashkinë e Fierit në 15 vitet e ardhshme është produkt i ndërthurjes së proceseve teknike e analitike të grupit të punës, me mendimin e pjekur qytetar. Përmes këtij vizioni synohet shtrirja e zhvillimit të drejtë e të barabartë si në zonat urbane, ashtu dhe në ato rurale, duke e konsideruar Fierin si një njësi ku vendbanimet, funksionet, banorët jetojnë përmes mbështetjes së ndërsjellë.

1. *Transparenca*

Përgjatë periudhës 4 vjeçare shtator 2019 – mars 2023, Bashkia Fier është përpjekur të rrisë transparençën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

- Ky prioritet ka ardhur duke u rritur vit pas viti. Fillimisht pengesë për ecurinë e tij ka qenë mangësia që kishte faqja zyrtare e bashkisë (WEB), struktura e të cilës nuk ishte shumë e përshtatshme për të krijuar një akses të lehtë dhe funksional për publikun e gjerë.
- Në vitin 2022 kjo faqe humbi totalisht funksionin për shkak të kolapsit që përfshiu serverat e AKSH-it dhe problemeve teknike të mbartura.
- Më vitin 2022 doli jashtë funksionit edhe e-maili zyrtar i këtij institucioni nga kjo goditje e sistemeve të AKSH-it, gjë që ktheu disa hapa pas progresin e bërë në këtë prioritet.
- Brenda disa javësh u realizua funksionimi i e-mailit zyrtar. Edhe pse nuk u arrit të riktheh i gjithë komunikimit i mëparshëm ndërinstitucional dhe me komunitetin, e-maili ka sjellë stabilitet në komunikim në vazhdimësi.
- BF^{ja} u angazhua për krijimin e një faqeje të re zyrtare të cilën e realizoi brenda vitit 2022 me burimet e veta njerëzore.
- Në vitin 2023 BF^{ja} ka faqen e re zyrtare¹⁷, e cila përmban edhe programin e transparencës me të gjitha fushat e saj të veprimit.
- Përfshirja e të rinjve në proceset vendimarrëse dhe vullnetit të bashkisë për të qenë më afër komunitetit ka njohur progres vit pas viti.
- Gjatë këtyre viteve, Bashkia Fier ka përdorur, por edhe ka testuar mënyrat më efikase të dhënies dhe shpërndarjes së informacionit: online, shpallje në vende me akses të gjerë dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë.
- Duke ardhur dhe duke filtruar rrugët më efikase të komunikimit me qytetarët, BF^{ja} ka nxitur atë online, duke qenë se është edhe më e përdorshme nga publiku.
- Për njoftimet e qytetarëve dhe grupeve të interesit, BF^{ja} përdor në mënyrë të vazhdueshme: informacionet dhe njoftimet online në rrjetet sociale dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë nëpërmjet kryepleqve të fshatrave, administratorëve, apo individëve influentë.
- Kanalet online të komunikimit të BF^{së} për informimin e publikut janë: Faqja zyrtare e bashkisë (WEB)¹⁸ dhe llogaria në rretin social FB¹⁹.
- Kërkesë - ankesat e qytetarëve bëhen në rrugë të ndryshme: nëpërmjet internetit në adresën zyrtare info@bashkiafier.gov.al, me shkresë nëpërmjet zyrës me një ndalesë (nëpërmjet koordinatorit të informimit), me postë, ose në kutinë postare (inbox) të llogarisë së bashkisë në FB.
- Rruga më e përdorshme nga qytetarët për dërgimin e një kërkesë –ankesë është online (e-mail/fb) dhe takime të drejtëpërdrejta me personat përgjegjës ose Kryetarin e Bashkisë.
- Duke filluar nga viti 2021, Bashkia Fier dhe Këshilli i Bashkisë Fier kanë nisur si praktikë publikimin në faqet respektive të tyre në rrjetin social FB, kalendarin e

¹⁷ <https://bashkiafier.gov.al/>

¹⁸ <http://bashkiafier.gov.al/>

¹⁹ <https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>

konsultimeve

publike për Buxhetin vjetor, Paketën Fiskale dhe PBA^{-në}, të shpërndarë në njësi administrative, me vendin dhe orën e zhvillimit.

- Publikimi i njoftimeve, së bashku me rendin e ditës mbi mbledhjet e këshillit bashkiak është një tjetër aspekt që nxit pjesëmarrjen dhe transparencën e vendimmarrjes. Ky njoftim bëhet në mënyrë sistematike nga ekzekutivi edhe pse në disa raste jo në afatin e përcaktuar nga ligji (5 ditë përpara datës së mbledhjes).
- Prania e të rinjve në mbledhjet e KB^{-së} tashmë ka krijuar një traditë, duke krijuar më shumë hapësirë për përgjegjshmëri, llogaridhënie dhe angazhim si nga ekzekutivi, ashtu edhe nga përfaqësuesit e qytetarëve (këshilltarët). Ata janë edhe pjesë e rëndësishme në takimet konsultative që këshilli dhe bashkia organizojnë.



- Ngritja e Këshillit Vendor Rinor Fier ka qenë një rezultat i punës dhe këmbënguljes së Epokës së Re, e cila e mundësoi këtë nëpërmjet shumë përpjekjesh dhe lobimesh me Bashkinë Fier dhe të rinjtë aktiv.
- Ngritja dhe fuqizimi i KVR^{-së} është një element që nxit, garanton pjesëmarrjen e të rinjve, qytetarëve dhe ndikimin e tyre në proceset vendimmarrëse.

2. Infrastruktura

Performanca në ofrimin e shërbimit të arsimit bazë dhe parashkollor do të përmirësohet duke përmirësuar kushtet në kopshte dhe shkolla, për të motivuar zhvillimin e mësimin sipas standardeve ligjore të përcaktuara.

Për përmirësimin e shërbimit të arsimit bazë dhe parashkollor, bashkia planifikon çdo vit buxhetor investime për rikonstuksione të ndërtesave shkollore, mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre, sigurimin e ngrohjes, etj.

Arsimi dhe sporti

kanë qenë prioritet i punës së bashkisë dhe janë cilësuar nga kryetari i saj, Armando Subashi, si shtylla kryesore, duke qenë se ato ecin paralel me njëra - tjetrën. Në këtë këndvështrim, investimet e plota në shkolla janë shoqëruar edhe me krijimin e terreneve sportive brenda ose jashtë godinave, sikurse edhe në disa raste të rikonstruksioneve të pjesshme, por nevojitet ende shumë punë për të siguruar plotësimin e këtij prioriteti. Duke qenë se tashmë ky prioritet është pjesë e axhendës së punës së qeverisjes vendore në mënyrë permanente, quhet një prioritet që ka njohur rrugën e realizimit.

- ❑ Si një nga objektivat e BF^{së}, përgjatë viteve 2019 – 2023, çdo sezon veror janë kryer ndërhyrje me punime të mirëmbajtjes së plotë dhe të pjesshme në të gjitha institucionet arsimore parashkollore dhe parauniversitare.
- ❑ Përgjatë këtyre viteve, në godinat arsimore janë investuar rreth 500 mln lekë, ku një pjesë e këtij fondi ka shkuar për krijimin dhe rikonstruksionin e terreneve sportive.
- ❑ Në territorin e Bashkisë Fier ushtrojnë aktivitetin e tyre këto insitucione arsimore:

- ✓ 21 shkolla të mesme publike dhe jo publike
- ✓ 3 shkolla profesionale (e Arteve të Bukura, Bujqësore, Industriale)
- ✓ 66 shkolla 9-vjeçare publike dhe jo publike
- ✓ 89 kopshte
- ✓ 3 çerdhe

- ❑ Në një vit shkollor numërohen rreth 20 000 nxënës nga të cilët 13905 frekuentojnë arsimin 9 vjeçar dhe 6018 arsimin e mesëm.
- ❑ Shkollat në qytet janë të pajisura me terrene sportive palestra dhe/ose fusha sportive brenda oborrit të tyre.
- ❑ Te gjitha shkollat që i janë nënshtruar ndërhyrjeve të plota apo të thella janë të plotësuara edhe me terrene sportive si të qytet ashtu edhe në zona rurale.
- ❑ Gjatë këtyre viteve janë ndërtuar 16 terrene sportive. Pritet të ndërtohen edhe 11 të tjera me fusha futbollit, basketbollit e volejbollit në të gjitha njësitë administrative, në funksion të projektit të përbashkët që BF^{ja} ka me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH-in) për krijimin dhe fuqizimin e klasave sportive.



*Niveli i ndërhyrjeve në godinat arsimore dhe shëndetësore
2019 - 2023*




Figure 4: Shpërndarja e investimeve në institucionet arsimore, shëndetësore.

22

- ❑ Bashkia ka hartuar kalendarin e veprimtarive sportive për të gjitha grupmoshat, djem dhe vajza, ku në një vit mësimor marrin pjesë mesatarisht 5000 nxënës.
- ❑ Pas disa ndërhyrjeve dhe investimeve të ndryshme infrastrukturore dhe në elemente bazë sportive, në vitin 2023 u arrit të inaugurohet pallati i sportit, pranë ETC-së.
- ❑ Në vitin 2022 u vendosën në funksion terrenet sportive pranë ETC-së, të cilat shërbejnë për të gjitha aktivitetet sportive dhe grupmoshat e ndryshme.
- ❑ Këtë vit pritet të nisë rikonstruksioni i katër shkollave me palestrat e tyre dhe terrenet e jashtme sportive si dhe ndërtimi i 2 palestrave të reja në shkollat: “Naim Frashëri” dhe “Liri Gero”.
- ❑ Shumë shpejt do të fillojë ndërtimi i shkollës së re në Sheq të Madh dhe rikonstruksioni i shkollave: “Naim Frashëri”, “Liri Gero”, “Mark Dashi”, 2 shkollat në Cakran, 1 shkollë në Varibop, 1 në Mbrostar Ura, 1 në Kafaraj, në Fermë Çlirim, Radostinë.



3. Shërbimet sociale

Bashkia Fier u angazhua maksimalisht për të bërë të mundur ngritjen e një qendre psiko – sociale, për gratë e dhunuara dhe fëmijët, por deri më sot ende nuk është arritur të bëhet realiztet. Sot BF^{ja} ka gati projektin dhe ka projektuar vendin se ku mund të ndërtohet kjo qendër. Ka lobuar vazhdimisht me Ministrinë, organizata të ndryshme edhe ndërkombëtare, por nuk ka mundur të gjejë mbështetje financiare. BF^{ja} është e gatshme të vërë në dispozicion godinën dhe stafin funksional për mbarëvajtjen e saj, por duket se ende prioritetet e Bashkisë Fier nuk përputhen me prioritetet e organizatave, apo Ministrisë, të cilat kanë qenë më shumë të fokusuara në ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve të ngritura më parë, apo mbështetjen e grupeve specifike si komunitetet: Rom/Egjiptian etj.

4. Vëmendje ndaj të rinjve


- ✓ Bashkia e Fierit ka një buxhet për fëmijët, të rinjtë dhe aktivitetet e tyre.
- ✓ Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Qendra e Aktiviteteve Kulturore, realizon të gjitha aktivitetet për të rinjtë dhe fëmijët.
- ✓ Në BF^{ja} ka gjithashtu një specialist që merret me koordinimin e të rinjve, KVR^{së} dhe ndërveprimin e tyre me qeverisjen vendore dhe qendrore.
- ✓ Në Bashkinë Fier, me vendim Nr. 104 të KBF^{së}, datë 07.12. 2021 është formalizuar ngritja e Këshillit Vendor Rinor Fier (KVR).
- ✓ Për herë të parë BF^{ja} ka mirëpritur prezantimin e 8 ide-projekteve të të rinjve të shkollave të mesme të bashkisë, nga të cilat ka miratuar për mbështetje financiare 7 prej tyre.



- ✓ Me buxhetin e vitit të ardhshëm 2024, pritet të realizohen dy prej projekteve të indeuara, të hartuara, të prezantuara, të nxitura dhe lobuara fort nga vet të rinjtë që janë:
Rikonstruksioni i palestrave të shkollave të mesme në Kafaraj dhe Fier (“Janaq Kilica”).

5. Vëmendje ndaj fëmijëve

QAK²⁰ është një qendër që aktivizon fëmijët në rrethe dhe kurse të ndryshme jashtëshkollore duke i aftësuar ata në drejtime të ndryshme, duke krijuar njëkohësisht edhe një resurs i kësaj qendre për aktivitetet që zhvillohen ajo gjatë vitit (pjesë e kalendarit të aktiviteteve të Drejtorisë së Artit dhe Kulturës (DAK), Bashkia Fier. Me një rritje frekuesntimi në mënyrë graduale vit pas viti, kjo qendër sot frekuentohet mesatarisht nga rreth 250 – 270 fëmijë e të rinj. Fëmijët, në mënyrë të organizuar, të ndarë në bazë interesash dhe preferencash individuale, frekuentojnë në bazë të një grafiku me orare të dakordësuara rrethet:



- Në bashkëpunim me Zyrën Vendore Aarsimore Fier dhe shkollat 9 – vjeçare e të mesme, kjo qendër disponon një kalendar vjetor të aktiviteteve të kthyer në traditë, ku përfshihen edhe kampionate në nivel lokal dhe rajonal.
- Ky organizim i punës, zgjerimi i fashës së aktiviteteve ku nxitet edhe pjesëmarrja e gjerë, ka për qëllim përfshirjen masive të nxënësve, si dhe evidentimin e vlerave më të mira të fëmijëve, kryesisht të të rinjve të shkollave të mesme.
- Teatri i kukullave, që kishte vite në harresë është rikthyer duke afruar çdo javë fëmijë dhe prindër pranë kësaj qendre. Gjatë sezonit veror teatri lëviz edhe në hapësirat e qytetit.
- Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, BF^{ja} ka krijuar një raport të ngushtë me institucionet e tjera vendore, grupet e interesit dhe shoqërinë civile.

²⁰<https://www.facebook.com/people/Qendra-e-Aktiviteteve-Kulturore-Fier/100075878440720/>



Interaktivitet



Aktivite të përvitshme:

- **Kërcim dashurie** – të rinjtë e shkollave të mesme (Shkurt)
- **Festa e 7 marsit dhe 8 marsit**– aktivitet me recitime, këngë, kërcime nga nxënës të shkollave fillore, 9 vjeçare/të mesme dhe të ftuar personalitete veteranë të arsimit fierak (janar – mars).
- **The best talents** – konkurs rajonal (poezi, interpretim, prezantim, këngë, kërcim)
- **Konkursi letrar** - në kuadër të Ditës Botërore të librit (23 prill).
- **Festa e valëve** – Çelja e sezonit të ri turistik, gara ndërkombëtare me kuaj. (Maj – qershor)
- **Hiking** - me të rinjtë gjimnazistë shtigje të reja turistike (Maj)
- **1 qershor si Myzeqar** - (Qershor)
- **Ditët verore** – aktivitete artistike të përjavshme (Qershor)
- **Festa e Grurit** – koha e shirjes së grurit, traditë myzeqare (Qershor)
- **Festa e Ansambllit Myzeqeja** (Qershor)
- **Banda Frymore** – koncert (Qershor– Korrik).
- **Maratona e këngës** - (Korrik)
- **Festa e miqësisë** - (Gusht)
- **Rrugë të mbarë drejt dijes** - Koncert me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor.
- **Aktivitet në nder të heroines Liri Gero** – (Shtator).
- **Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore** - (Shtator)
- **Tetori i librit** – aktivitete me shkollat 9 vjeçare e të mesme (Tetor).
- **Krosi i vjeshtës** – me shkollat 9 vjeçare e të mesme (Tetor).
- **Festa e 15 tetorit** – koncert me këngë, valle, recitime e prezantimetëndryshme (Tetor).
- **Të njohësh hitorinë dhe traditën**– koncert me këngë dhe recitime (Tetor).
- **Konkurs i fjalës Artistike** - (Nëntor)
- **Koncert me rastin e 28 – 29 Nëntort** - (Nëntor)
- **Dhjetori, muaji i festave** - Aktivitete të ndryshme ditore në qytet me këngë, valle, lojëra etj. (Dhjetor)



Gjetje nga komuniteti

Kontrata Sociale në vetvete është një produkt i dalë nga komuniteti dhe si i tillë kërkon në çdo hap ballafaqim po me komunitetin, për të parë ndryshimet e ecurisë kohë pas kohe dhe për të dhënë një përfundim të plotë mbi progresin ose regresin e këtij produkti.

Për këtë arsye, krahas monitorimit dhe grumbullimit të informacioneve nga ana e qeverisjes vendore është punuar edhe me komunitetin, duke vjelë mendimin e tyre. Ekipi i punës nuk është mjaftuar vetëm me një mendim sipërfaqësor në lidhje me ecurinë e këtij procesi dhe progresin e prioritetëve të KS-së nga ana e BF-së, por është munduar që nëpërmjet grupeve të vogla me bazë komunitet miks, të hulumtojë edhe indikatorët e ndërhyrjes që çojnë në realizim të tyre.

26

Gjatë periudhës shtator 2019 – mars 2023, qendra Epoka e Re ka realizuar mesatarisht çdo vit 7 fokus grupe me grupe të vogla me bazë komunitare, të ndara në interesa të përcaktuara si: gratë, të rinjtë, komunitetet në zonat rurale dhe urbane, përfshirë grupet e marginalizuara, biznese etj.

Fokus grupet u përqendruan në ecurinë e procesit të përmbushjes së kontratës sociale. U diskutuan rreth realizimeve dhe problematikave të hasura, duke përshkallëzuar në bazën e rëndësisë, ecurinë së tyre dhe sa ndikim kanë patur ato në jetën e komunitetit dhe sa u kanë shërbyer atyre. Duke u thelluar në pyetjet kyçe për hulumtimin e mendimit qytetar u përshkallëzua edhe marrja e përshtypjeve mbi performancën e qeverisjes vendore kundrejt

ofrimit të shërbimeve në përgjithësi.



□ **Transparenca**

- Gjatë periudhës së shtrirjes së ndikimit të Kontratës Sociale POP 2019, pavarësisht se janë ndier shenja përmirësimi, perceptimi qytetar duket se ka një stabilitet në përfundimin e vet duke e kategorizuar atë si një prioritet që vazhdon të jetë në kushte lehtësisht të luhatshme nga situata të ndryshme.

27

- Ata janë shprehur se BF^{ja} tregohet transparente atëherë kur ajo ka interesin e vet dhe herë pas here shfaqet shumë e mbyllur për çështje të cilat mund të jenë edhe më me shumë në interes për qytetarët se ato që ata publikojnë me shumë pompozitet.
- Të rinjtë janë ata që ndihen më pranë qv^{së} nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e KBF^{së} si edhe në aktivitete të tjera me pjesëmarrje publike dhe kjo jo të nxitur nga qeverisja, por më tepër të organizuar nga Epoka e Re.
- Edhe pas një periudhe 4 vjeçare të zbatimit të kësaj kontrate dhe lobomit të vazhdueshëm që i është bërë nxitjes së pjesëmarrjes qytetare, komuniteti vazhdon të ndihet i tërhequr nga proceset vendimmarrëse.
- 46% e tyre janë shprehur se nuk kanë ndjekur asnjëherë ndonjë mbledhje të KBF^{së} as live dhe as në media.
- Rreth 10% e tyre janë shprehur se kanë marrë pjesë të paktën një herë në mbledhjet e KBF^{së}, por nuk e ndjekin aktivitetin e Bashkisë apo Këshillit të Bashkisë në media, apo rrjetet sociale.
- 44% janë shprehur se e ndjekin aktivitetin e BF^{së} dhe KBF^{së} në të gjitha kanalet e komunikimit, përfshirë rrjetet sociale, kanalet zyrtare apo mediat vizive.




Figure 5: Intersi I komunitetit ndaj veprimtarisë së BF dhe KBF

- 27% e tyre janë shprehur se e vizitojnë shpesh herë faqen zyrtare të bashkisë.
- 39% janë shprehur se e kanë vizituar të paktën një herë faqen zyrtare të bashkisë.
- 24% janë shprehur se nuk e kanë patur të nevojshme vizitën e faqes zyrtare.
- 10% nuk e kanë informacionin rreth këtij kalali informimi dhe komunikimi.




Figure 6: Niveli I përdorimit të EEB –BF për marrjen e informacioneve

- Lidhur me cilësinë e informacioneve të marra nga kjo faqe, pjesa aktive e komunitetit që pohoi përdorimin e saj ndahej në:
 - 48% janë shprehur se kanë marrë informacion të mjaftueshëm për atë çfarë u duhej.
 - 36% janë shprehur se kanë marrë informacion, por jo të plotë.
 - 16% janë shprehur se nuk kanë mundur të gjejnë informacionet që dëshironin. Ka mungesë informacioni.




Figure 7: Cilësia e informacionit në WEB-in zyrtar të BF-së

- Në komunitetin e zonave rurale ndihet shumë pak nevoja e marrjes së informacionit nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit. Kjo për shkak të një tradite që ende nuk po zbehet dhe që lidhet me besimin. Ky komunitet është shprehur se ka nevojë të ketë informacion për problematika apo çështje të ndryshme që ndikojnë në jetën e tyre, por nuk e shohin këtë si një mënyrë efektive. Kjo vjen nga një praktikë e trashëguar që ka lënë gjurmë duke besuar se informacioni që jepet në mënyrë të drejtëpërdrejtë është më i saktë se ai që mund të marrësh në kanale informimi online edhe pse kjo mund të jetë zyrtare.
- Krejt e kundërta shfaqet në komunitetin e zonës urbane. Qytetarët janë të ndarë në ata që besojnë në informacionet e publikuara nga institucioni, ata që nuk mjaftohen me ato që janë të publikuara dhe në ata që kërkojnë mënyra më të thjeshta për publikimin e informacionit (kryesisht për thjeshtimin e informacioneve të buxheteve), ku mendojnë se duhet përdorur një gjuhë më pak teknike që të jetë e kuptueshme edhe nga nivelet më të ulëta të formimit arsimor.
- Vit pas viti vihet re se komuniteti në zonën urbane dhe ato rurale e kanë rritur nivelin e informacionit edhe për pjesëmarrjen e lirë të tyre në mbledhjet e KBF-së, por interesi i tyre për të qenë pjesë në këto mbledhje mbetet akoma i ulët. Kjo për shkak të mungesës së interesit të tyre ndaj vendimmarrjes, mungesës së besimit, ose gjejnë mënyra të tjera për t'u informuar mbi këtë zhvillim.
- Të rinjtë janë ata që kanë bërë një revolucion në lidhje me transparencën dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje. Gjatë periudhës 2019 – 2023 shihet një rritje e ndërgjegjësimit dhe besimit të tyre në forcën që ata kanë për të qenë ndikues në vendimmarrje nga 9% në vitin 2019, në rreth 47% në vitin 2023, përfshirë këtu nxënës të shkollave të mesme dhe nxënës të shkollave 9 vjecare niveli i lartë.




Figure 8: Niveli i pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje

□ Infrastruktura


Ky prioritet nuk ka të bëjë vetëm me të rinjtë, por me të gjithë komunitetin: shkolla më të mira, oborre të sistemuara, terrene sportive për fëmijët dhe të rinjtë. Si një nga shtyllat kryesore të punës së BF^{së} ka ecur paralel me objektivin e projektit POP edhe pse ende nuk mund të themi që është një prioritet i realizuar, pasi nevojat vazhdojnë të jenë të mëdha, kryesisht për të veshur me terrene sportive zonat rurale dhe për të unifikuar me standardin e nevojshëm të gjitha palestrat dhe fushat sportive në të gjithë territorin e BF^{së}.

30

- **Problematike vazhdon të mbetet situata në shkollën “Sheq i Madh”.** Qytetarët vazhdojnë të jenë në pritje të investimit të BF^{së}. Ata janë të informuar mbi përfundimin e hartimit të projektit dhe punën e bërë nga ana e bashkisë për sigurimin e financimit, por ende nuk dinë se kur do të realizohet.
- Mungesa e terreneve sportive dhe situata e atyre ekzistuese mbetet një tjetër shqetësim për komunitetin. Ata janë koshientë që është punuar në këtë drejtim për krijimin e hapësirave sportive edhe në zonat rurale, por kjo nuk ka plotësuar të gjitha nevojat e tyre, pasi shumë zona vazhdojnë të mos e kenë këtë shërbim të përmirësuar.
- Shkollat, të cilat i janë nënshtruar rikonstruksionit të plotë, në masën 90% të tyre janë shoqëruar edhe me ndërhyrje të thella në terrene sportive apo palestra, por sipas qytetarëve, pjesa më e madhe e zonave rurale vazhdojnë të kenë mungesa të këtyre terreneve, duke qenë se mungojnë edhe hapësirat publike në këto zona, të përshtatshme për aktivitete rekreative, sportive, apo argëtuese.
- Atë që komuniteti e ka parë si një arritje të drejtëpërdrejtë të projektit POP dhe të rinjve të kësaj shkolle është realizimi i projektit për rikonstruksionin e palestrës së shkollës në Kafaraj, ku të gjithë kishin humbur shpresat se mund të realizohej për shkak të uljes së numrit të nxënësve, frekuentimit të ulët të saj dhe investimit të thellë që kërkonte kjo palestër. Ata janë shprehur se kanë kërkuar gjithmonë këtë investim, por pa rezultat. Falë

lobimit të të rinjve të mbështetur dhe aftësuar nga Epoka e Re, arritën të hartojnë një projekt specifik, ta prezantojnë atë në bashki, të marrin miratimin e financimit dhe ta monitorojnë deri në planifikimin e tij në tabelat e buxhetit vjetor.

- Një tjetër problem i ngritur nga qytetarët që nuk ka marrë zgjidhje është edhe vënia në funksion i shkollave si qendra komunitare. Gjatë kësaj periudhe janë dhënë disa modele të funksionimit të shkollave si qendra komunitare, por që duket se nuk kanë qenë të suksesshme. Edhe ato pak modele kanë patur si qëllim vetëm hapjen e terreneve sportive të shkollave për akses të lirë të fëmijëve dhe të rinjve pas orarit të mësimin, por nuk ka patur asnjë nismë tjetër nga ana e strukturave institucionale për ta shoqëruar me burime njerëzore, të cilat të jenë jo vetëm mentor, por edhe animatorë për të zhvilluar aktivitete të ndryshme brenda territorit të shkollave. Kjo situatë ka edhe një faktor tjetër frenues që lidhet me frikën e stafit drejtues të shkollave. Ata stepen për hapjen ambienteve të shkollave për frekuentim nga komuniteti pas procesit mësimor, për të evituar dëmtimet e mundshme nga veprimet e papërgjegjshme të personave që do të jenë frekuentues pa asnjë ngarkesë përgjegjësie. Në këto kushte, deri në qartësimin e kësaj situatë, shkolla - qendër komunitare mbetet një ngërç që pritet të zgjidhet me një marrëveshje ndër-institucionale.



□ Shërbimet sociale


Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë është një nevojë që gjithmonë ka tërhequr vëmendjen e komunitetit kryesisht grave dhe vajzave, por mbetet ende një ëndërr për komunitetin e Fierit. Gjatë fokus grupeve me target gratë dhe të rinjtë, hapja e një qendre të tillë në Fier shihet me shumë interes, duke vënë re edhe rastet e shtuara të dhunës në familje (kryesisht ndaj grave dhe vajzave, pa përjashtuar edhe fëmijët). Hapja e një qendre të tillë, me shërbime të larmishme ditore do të krijonte një mundësi për të gjitha ato gra, nëna e vajza që ndeshen me mizorinë e dhunës dhe detyrohen të bashkëjetojnë me të për shkak të mungesës së një strehe të sigurt dhe vazhdojnë të jenë të kërcënuara ndoshta edhe me jetën. Fakti

që ende nuk ka asnjë dritë jeshile për ngritjen e një qendre të tillë në Fier e bën këtë prioritet pa adresim, edhe pse me një përqindje rritëse për faktin e përpjekjeve të BF^{së} për finalizim e saj.



□ Vëmendje ndaj të rinjve

- Të rinjtë kanë qenë kryesisht target grupi që ka vlerësuar realisht progresin e këtij prioriteti, falë lobimit të vazhdueshëm të qendrës Epoka e RE. Ata kanë vlerësuar gjithashtu edhe vullnetin e treguar nga institucioni i qeverisjes vendore për përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse, pavarësisht se ka qenë edhe një orientim ligjor.
- Ata janë shprehur se kanë informacion për ngritjen e Këshillit Vendor Rinor Fier dhe kanë treguar interes në fuqizimin e këtij instrumenti që do e bëjë zërin e tyre më të fortë në proceset vendimmarrëse lokale në vijim.
- KVR^{ja} shihet nga komuniteti i të rinjve si një formë institucionale e rinisë për të depërtuar në disa procese që më parë kanë qenë të panjohura për ta. Ky është një hap i madh i hedhur gjatë kësaj periudhe, që do të reflektojë nxitje të transparencës, të përgjegjshmërisë, të llogaridhënies dhe të qeverisjes së mirë.
- Lobimi ka qenë gjithashtu një formë që të rinjve janë shprehur se edhe nëse nuk kanë qenë vet pjesë e tyre janë në dijeni që shumë të rinj, janë organizuar dhe mentoruar nga Epoka e Re në hartimin e disa projekteve dhe kanë mundur t'i paraqesin ato pranë BF^{së} dhe kanë arritur të “rërëmbejnë” miratimin për financimin e disa prej tyre. Një arritje kjo që ka rritur besimin tek të rinjtë dhe një pjesë të komunitetit që përditësohet me informacionet nga publikimet online.





□ Vëmendje ndaj fëmijëve

- Qendra e Aktiviteteve Kulturore, Bashkia Fier është një nga prioritetet që ka njohur një progres të dukshëm. Edhe nga mendimi qytetar shprehet qartë ky progres. Të rinj, fëmijë, prindër dhe mësues janë shprehur të kënaqur me mënyrën e organizimit të kësaj qendre që për disa vite kishte humbur identitetin e saj. Fëmijët dhe të rinjtë kishin humbur fare interesin për faktin se në këtë qendër ishin mbyllur shumë rrethe dhe kishte një vakum aktivitetesh artistike e kulturore.
- Edhe pse interesat e të rinjve kanë pësuar ndryshim të reflektuar nga zhvillimet e kohës, përsëri QAK^{-së} i është rikthyer gjallëria dhe fluksi i madh i fëmijëve dhe të rinjve që frekuentojnë rrethet dhe aktivitetet e ndryshme që kjo qendër organizon.
- Rikthimi i kurseve, rretheve, konkurseve, kampionateve sportive, garave, apo nismave të ndryshme, duket se kanë qenë gjithçka që i nevojitej plotësimit të kësaj nevoje komunitare.
- Aktualisht QAK-ja është kthyer në një institucion që zhvillon talente të reja në çdo fushë, aktivizon të rinj e fëmijë në kurset dhe rrethet e formimit të përqendruar, i promovon ata në aktivitete të larmishme që ideon dhe organizon vet, duke nxitur tek ky brez dëshirën për të mësuar, aftësuar në drejtimet e interesit, nxitur përfshirjen e tyre në aktivitete jashtëshkollore, duke i larguar nga jeta pasive.

■ Progresi i KS-së

Përgjatë viteve 2019 – 2023, Kontrata Sociale ka qenë epiqendra rreth së cilës është organizuar puna organizative, informuese, hulumtuese dhe lobuese e qendrës Epoka e Re për të siguruar realizimin e prioriteteve të komunitetit. Gjatë kësaj periudhe ka patur zhvillime dinamike rreth disa prej tyre dhe me hapa të ngadaltë në një pjesë prej tyre.

Në grafikun e mëposhtëm tregohet progresi i prioriteteve ndër vite me një mesatare zhillimi dhe realizimi, pasi ende nuk ka një referencë ekzakte që mund të kryhet matja e progresit në çështje me gamë të gjerë. Në të 5 prioritetet, ajo që mund të shihet si një element me matshmëri konkrete është vetëm ngirtja e një qendre pritëse psiko – sociale, por përpjekjet për realizim përsëri kanë një matshmëri relative.

Në lidhje me trasparencën dhe infrastrukturën e shkollave, terreneve sportive edhe pse është punuar dhe ka marrë vëmendje nga qeverisja vendore përsëri mbetet shumë për të bërë. Për fokusin e kontratës mund të quhet si një prioritet i realizuar, pasi është përfshirë në axhendën e qeverisjes vendore dhe është një nga shtyllat e saj të punës, por deri në momentin që ende ka shumë shkolla pa investim, pa palestra dhe terrene sportive mbetet një prioritet që kërkon ende angazhim.

Përsa i përket buxhetit për rininë dhe rijetësimin të QKF-së kemi një arritje më të madhe, por përsëri lind nevoja për vijueshmëri dhe monitorim.

34




Figure 9: Progresi i realizimit të prioriteteve të KS-së

Analiza e prioriteteve

Transparenca

Transparencë në menaxhinin e Njësisë së qeverisjes vendore, duke nisur nga njoftimet publike, shpërndarja e informacionit pa kërkesë dhe konsultimet publike. Ato duhet të jenë më të shpeshta, të shtrira në kohë dhe gjithëpërfshirëse;

Ky prioritet ka qenë dhe mbetet një nga kriteret bazë të lidhjes së fortë të qytetarëve me qeverisjen. Si prioritet i KS^{së}, transparenca ka ardhur gradualisht duke rritur shkallët e përmbushjes me elementë të shtuar vit pas viti. Edhe pse themi se është një prioritet deri diku i plotësuar mbetet ende për të vijuar monitorimin e ecurisë në vazhdimësi.



Në vitet e para 2019 – 2020 kishte një ngërç në mënyrën e paraqitjes së informacioneve nga qeverisja vendore në pasqyrat zyrtare të publikimit, duke parë një tërheqje të opinionit public, ndikuar nga mungesa e besimit. Në vitet 2020 – 2022, bashkia Fier kishte një faqe zyrtare të saj - WEB ku publikonte informacionet e ndryshme pa kërkesë të publikut, por me një problematikë evidente. Këto informacione nuk ishin paraqitur në mënyrën e duhur për t'iu servirur përdoruesve me akses të plotë dhe ishin mjaft të ndërlikuara në përdorimin e tyre. Ishte e vështirë të hapje një dokument apo të shkarkoje një informacion nga celulari. Duke qenë se ky ishte një ngërç i hasur gjatë hulumtimit dhe monitorimit, i është sugjeruar BF^{së} që të përmirësonte këtë faqe, ose të krijonte një faqe të re me akses më të plotë dhe të thjeshtë në përdorim.

35

Nga viti 2022-2023, BF^{ja} punoi për ndërtimin e një faqeje të re dhe sot kemi një WEB të ri, funksional dhe më të thjeshtë në aksesueshmëri publike²¹. Ajo që vihet re është apatia që qytetarët kanë ndaj frekuentimit të formateve zyrtare, por kanë një tërheqje të shtuar në rrjetet sociale si llogari më të popullarizuara. Për këtë arsye, kjo është edhe kanali më i përdorshëm nga institucioni me qytetarët. Të gjitha njoftimet e ndryshme insitucionale, përfshirë edhe ato për konsultimet publike, publikohen në rrjetet sociale, ku vërrehet qartë kujdesi ndaj këtij kanali edhe në rifreskimin e publikimeve.

Pjesë e rëndësishme e transperencës ka qenë edhe pjesëmarrja në vendimmarrjen lokale, ku mbledhjet e Këshillit të Bashkisë ishin pothuajse të mbyllura në kontekstin publik edhe pse jo ligjor. Nga monitorimet e bëra ndër vite është konstatuar se qytetarët nuk e kishin fare informacionin që mbledhjet ishin të hapura për publikun dhe se ato mund të ndiqeshin lirisht prej tyre. Një pasivitet i tillë në këto 4 vite ka ardhur duke u minimizuar dhe kjo falë frymës së re që të rinjtë e informuar, orientuar dhe motivuar kanë arritur të përcjellin për qytetarët dhe vet Këshillin e Bashkisë. Të rinjtë kanë luajtur një rol monitories dhe lobues nëpërmjet shembullit personal dhe kanë arritur të krijojnë një tjetër imazh të mbledhjeve të KB^{së}, duke nxitur rritjen e

²¹ <https://bashkiafier.gov.al/>

trasparençës në vendimmarrjet lokale, këtij procesi kaq shumë të rëndësishëm me ndikim të fortë në komunitet.

Infrastruktura

Ndërtimi i sa më shumë terreneve sportive në qytet dhe Njësi Administrative, si dhe vënia në funksion e shkollave si qendra komunitare, kryesisht në zonat rurale.

Infrastruktura është një nga fushat ku prioriteti I komunitetit bashkohet më atë të qeverisjes. Pikërisht këtu përqendrohet edhe buxheti vjetor dhe afatmesëm I Bashksië Fier.

Bashkia financohet në raportin rreth 51% me 49% nga të ardhurat e veta dhe transfertat e qeverisë qendrore. Bashkia siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave nga burimet e veta, kryesisht nga taksat dhe tarifat vendore. Ky është një tregues pozitiv për punën e bashkisë, stabilitetin ekonomik dhe zhvillimin ekonomik lokal, duke ndikuar në uljen e varësisë nga të ardhurat që vijnë nga buxheti qendror.

36




Figure 10: Raporti (mesatar) i buxhetit të BF-së

Administrimi i bashkisë, shërbimet publike vendore, arsimit bazë dhe parashkollor, menaxhimi i mbetjeve dhe trashëgimia kulturore zënë peshën më të madhe në financimin e buxhetit të bashkisë. Fondet për një pjesë të funksioneve të bashkisë janë përfshirë tek administrimi i bashkisë.

Shkollat, por në përgjithësi të gjitha institucionet e arsimit parashkollor dhe parauniversitar kanë qenë pjesë e prioritetëve të BF-së. Të para në këtë këndvështrim, ato ecin paralel me sportin si një tjetër prioritet që lidhet me jetën e shëndetshme dhe kulturën e masivizimit të tij, duke e lidhur me krijimin e ekipeve zinxhir që ka në fokus BF-ja. Në këtë prizëm, projektet dhe investimet në

institucionet arsimore, gjatë këtyre viteve janë shoqëruar me krijime dhe ristrukturime të terreneve sportive brenda dhe jashtë tyre.

Angazhimi i projektit POP ka qenë një busull edhe për të nxitur orientimin e ndërhyrjeve në terrene sportive, por gjendja e rënduar e tyre dhe në përgjithësi e gjithë infrastrukturës në shkolla, çedhe, kopshte, rrugë, institucione shëndetësore, sistem bonifikues, shërbime etj, të cilat janë trashëguar të tillë pas reformës së thellë administrative – territoriale, ka bërë që vëmendja të shëndahet dhe bashkë me të edhe mundësitë.

Bashkia Fier e ka cilësuar si një shtyllë të punës së saj infrastrukturën e shkollave, kopshteve, çerdheve. Përgjatë viteve 2019 – 2023, çdo sezon veror, ajo ka ndërhyrë me punime të mirëmbajtjes së plotë dhe të pjesshme në të gjitha institucionet arsimore parashkollore dhe parauniversitare. Edhe pse me një numër të shtuar ndërhyrjesh gjatë këtij 4 vjeçari, është e nevojshme intesifikimi i investimeve në godinat arsimore dhe terrenet sportive.

Përgjatë këtyre viteve, në godinat arsimore janë investuar rreth 500 mln lekë, ku një pjesë e këtij fondi ka shkuar për krijimin dhe rikonstruksionin e terreneve sportive.

Gjatë këtyre viteve janë ndërtuar 16 terrene sportive dhe pritet të ndërtohen edhe 11 të tjera me fusha futbollit, basketbollit e volejbollit në të gjitha njësitë administrative, në funksion të projektit të përbashkët që BF^{ja} ka me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH-in) për krijimin dhe fuqizimin e klasave sportive.

37

Bashkia ka hartuar kalendarin e veprimtarive sportive për të gjitha grupmoshat, djem dhe vajza, ku në një vit mësimor marrin pjesë mesatarisht 5000 nxënës.

Në vitin 2021 u vunë në funksion terrenet sportive pranë ETC^{-së}, ku organizohen aktivitete të ndryshme sportive.

Pas disa investimeve thelbësore në pallatin e ri të sportit pranë ETC^{-së}, në vitin 2023 u bë inaugurimi i tij me një ndeshje kombëtare. Këto ambiente, pavarësisht se janë projektuar si ambiente sportive kanë hapësirat e nevojshme dhe kushtet që të shërbejnë edhe si qendra multifunkionale ku zhvillohen edhe aktivitete të ndryshme kulturore edukative.

Ajo që mbetet ende pa ndonjë progres të dukshëm është funksionimi i shkollave si qendra komunitare. Për këtë nevojitet një koordinim mes qeverisjes vendore dhe qeverisjes qendrore për të aktivizuar resurset humane dhe infrastrukturore. Nuk është vetëm mungesa infratrakturore ajo që pengon funksionimin e shkollave në qendra komunitare, por edhe mungesa e një stafi mbikqyrës, apo vullnet i përbashkët.

Aktualisht në territorin e Bashkisë Fier funksionojnë 3 (tre) qendra komunitare: Levan, Baltëz dhe Fier qytet, në pjesën më të madhe të të cilave frekuentohen nga komuniteti rom/egiptian.

Si qendra komunitare janë përshtatur ambientet e jashtme të shkollave, në ato zona ku mungon totalisht hapësira publike. Në zonat me hapësirë të mjaftueshme publike në qendër të tyre është krijuar mundësia e një miniparku që shërben si “mjedis komunitar”, por që frekuentohet vetëm nga moshë e tretë.

Qendra pritëse

Ndërtimi i një qendre pritëse psiko-sociale për gratë e dhunuara dhe grupet në nevojë.

Pavarësisht vullnetit të bashkisë dhe përpjekjeve për çdo mënyrë bashkëpunimi, përfshirë bashkëfinancimin, përsëri mbetet një prioritet i pa adresuar.




Figure 11: Progresi ndër vite i priorititetit të hapjes së qendrës psiko - sociale

Ka qenë një lobim i vazhdueshëm i qendrës Epoka e Re nëpërmjet projektit POP, për ngritjen e një qendre pritëse psiko sociale, pjesë e prioriteteve të KS^{-së} që zgjoi interesin e BF^{-së}. Kjo është një çështje e diskutuar masivisht me komunitetin, kryesisht me gratë dhe është një nevojë e mbështetur si e tillë edhe nga qeverisja vendore. Hapja e kësaj qendre shihet si një domosdoshmëri për bashkinë e Fierit si një ndër qytetet me popullsi të konsiderueshme dhe në rritje, por që mund të funksionojë edhe për bashkitë e tjera të qarkut. Kjo e fundit u angazhua për hartimin e një projekti dhe nisjen e negociatave me donatorë të ndryshëm, biznese apo grupe interesi për të mundësuar financimin e saj, por deri më sot jemi në kushtet që ende nuk është arritur realizimi i këtij prioriteti.

Nga ana e BF^{-së} projekti tashmë është gati, vendi për zbatimin e tij gjithashtu është gjetur nga ana e Bashkisë, por ende nuk është bërë e mundur gjetja e një financimi apo bashkëfinancimi të mundshëm. Ky projekt është lobuar dhe vijon të llobohet vazhdimisht me Ministrinë, organizata të ndryshme edhe ndërkombëtare, por ende nuk ka mundur të gjejë mbështetje financiare. Qasjet

e qeverisë vendore dhe asaj qendrore, por edhe të ndërkombëtarëve në këtë pikë duket sikur nuk përputhen, duke e lënë pa mbështetje këtë kërkesë të vazhdueshme.

Ky prioritet vazhdon të jetë pjesë e lobimit dhe orientimit të vëmendjes së vendimmarrësve nga ana e projektit POP, për të arritur realizmin e tij në të ardhmen e afërt.

Buxhet për të rinjtë

Buxhet specifik për të rinjtë dhe ngritja e një strukture (Drejtore) të veçantë në bashki që të koordinojë marrëdhënien dhe ndërveprimin me të rinjtë.

Ky prioritet klasifikohet i adresuar dhe një arritje e projektit POP dhe Epokës së Re edhe pse kërkon ende përpjekje për ta përsosur orientimin e buxhetit për rininë dhe ndarjen e tij nga zërat e aktiviteteve të tjera kulturore, promovuese, sportive etj, që aktualisht janë në të njëjtin zë buxhetor.

39




Figure 12: Progresi i prioritetit për buxhetin për rininë

Aktualisht në BF-it ka:

- Një specialist që merret me koordinimin e marrëdhënieve dhe ndërveprimin me të rinjtë.
- Një Këshill Vendor Rinor.
- Rritje e numrit të të rinjve në formacionin e KBF-së.
- Të rinjtë aktiv në procese vendimarrëse që njoftohen, aktivizohen rregullisht, nxiten për të qenë aktiv dhe kërkues nga qeverisja vendore.

- Të rinjtë janë bërë faktor në pjesëmarrjen qytetare, por edhe proceset vendimmarrëse në Bashkinë Fier. Ata llobojnë, diskutojnë, trajtojnë problematika dhe priren të ndikojnë në vendimmarrje.
- Ngritja dhe fuqizimi i KVR^{-së} e bën edhe më të sigurt evolimin e këtij prioriteti gjatë punës në vazhdim.
- Të rinjtë janë prezent pothuajse në çdo mbledhje të KBF^{-së}, në takimet consultative, apo aktivitete të institucioneve vendore.
- Të rinjtë arrijnë të artikulojnë qartë çfarë duan dhe ta depërtojnë atë në organet vendimmarrëse nëpërmjet KVR^{-së}.
- Bashkia Fier ka arritur të mbështesë iniciativat e të rinjve, projektet dhe idetë e tyre me grande, duke hapur kështu një dritare të re bashkëpunimi.

Kthimi në identitet i QKF

40

Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve, duke rikthyer gjithashtu edhe grupet e kurset e fëmijëve, të cilët sot janë të pa përfaqësuar.

Ky prioritet ka nisur në mënyrë graduale dhe ka progresuar vit pas viti. Kthimi në identitet i Qendrës Kulturore të Fëmijëve (ose siç emërtohet sot Qendra e Aktiviteteve Kulturore, kjo për shkak të përfshirjes edhe të të rinjve në aktivitete dhe organizime të ndryshme), duke rikthyer gjithashtu edhe grupet, rrethet dhe kurset jashtëshkollor për fëmijët dhe të rinjtë, të cilët ishin të pa përfaqësuar ka qenë më shumë se një prioritet i kontratës. Për vet atakimin e pjesës më të brishtë të komunitetit dhe shoqërisë, njëkohësisht të ardhmes së saj, ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm për të gjithë komunitetin, kryesisht ato familje që kanë fëmijë të grupmoshës 6 – 18 vjeç.

Vitet e para të zbatimit të kësaj kontrate 2019 – 2021, kjo qendër kishte një apati dhe mungesë të larmishmërisë së aktiviteteve të saj. Kurset, rrethet nuk funksiononin më ose qëndronin të hapura, por nuk frekuentohesh pothuajse fare. Qëllimi i ngritjes së kësaj qendre, dikur Shtëpia e Pionierit, më pas Qendra Kulturore e Fëmijëve, ka qenë angazhimi i fëmijëve të moshës 6-14 vjeç. Sot ka ndryshuar fokusi i kësaj qendre! Për të mos lënë jashtë vëmendjes të rinjtë, ky

institucion kulturor, artistik e sportiv, përfshiu në organizime edhe të rinjtë deri në moshën 18 vjeç, duke përmbushur kështu një nga pikat e prioritetit për ata që ishin të pa përfaqësuar.

Gjatë periudhës 2021 – 2023 fizionomia e kësaj qendre ka ndryshuar tërësisht. Ajo frekuentohet masivisht nga fëmijët dhe të rinjtë, të cilët marrin pjesë në kurset, rrethet dhe grupet e shtuara të saj në: këngë, muzikë, pikturë, kërcim, shah, sport, gazetari, letërsi, aktrim, etj.

Sot kemi një prioritet të përmbushur, por që ka nevojë për t’u monitoruar dhe zhvilluar.




Figure 13: Progresi i prioritetit të kthimit në identitet të QKF-së

Rekomandime

Kontrata Sociale 2019 ka qenë një objektivi jo vetëm për projektin dhe rrjetin POP, apo qendrën Epoka e Re, por edhe për komunitetin. Të rinjtë kanë qenë pjesa më e angazhuar e komunitetit që nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime, konsultime, mbledhje të Këshillit të Bashkisë, etj, kanë nxitur vëmendjen e qeverisjes vendore për të garantuar një progres sa më të madh të këtyre prioritetëve.

Gjatë periudhës së shtrirjes së kësaj kontrate, e gjithë puna informuese, lobuese, hulumtuese, monitoruese e bërë në këtë fokus ka sjellë ndryshime të mëdha, pavarësisht se ende nuk kemi një përmbushje të plotë të tyre.

Qendra Epoka e Re, projekti POP nuk do të ndalet në këtë mision të nisur për përmbushjen e prioritetëve të kësaj kontrate me komunitetin dhe përfaqësuesit e qeverisjes vendore dhe vendimmarrësve vendor, por do të vazhdojë punën monitoruese, lobuese dhe nxitëse deri në realizimin e tyre.

Bazuar edhe në nivelin e angazhimit, disponueshmërisë dhe vullnetit të qeverisjes vendore janë klasifikuar si të nevojshme disa ndërhyrje:

Qeverisjes vendore

- Shtimi i vëmendjes ndaj sporteve dhe terreneve sportive në zonat rurale, nëpërmjet sistemimit edhe të fushave ekzistuese apo shesheve të tjera publike që aktualisht kanë mbetur pa asnjë funksion.
- Rritje e vullnetit të qeverisjes vendore për të bashkëpunuar me OSHC^{të} e ndryshme locale dhe qendrore, që kanë në fokus sportet, duke lejuar akses dhe mbështetje në krijimin e një tradite jetësore (stil jete) me sportin.
- Forcimi i qasjes ndaj mbështetjes së projekteve rinore dhe nga të rinjtë për të krijuar një frymë të re konceptimi mbi stilin qeverisës në qytetin e tyre.
- Rritja e vlerës së KVR^{-së} në konceptin qeverisës dhe ndikimit të saj në proceset vendimmarrëse.
- Fushata informimi mbi web-in e ri të BF^{-së} dhe nevojën e përdorimit të tij për të evituar kështu ecejaket e shumta të qytetarëve për një informacion që mund ta marrin nga kjo faqe në mënyrë të lehtë dhe të shpejtë.
- Plotësim sa më shpejt i faqes së re WEB me infomacione dhe azhornim i vazhdueshëm, pasi ende ka mungesë dhe ndihet një frymë pasiviteti herë pas here.
- Vullnet në rritje i nxitjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe hulumtuese, si pjesa më vitale dhe me një mendim jashtë petkut institucional e politik.
- Të ndahet zëri i buxhetit për të rinjtë nga buxheti për aktivitete.
- Marrëveshje ndërinstitutionale për të aktivizuar resurset humane dhe infrastrukturore për të siguruar funksionimin e shkollave si qendra komunitare.

Epoka e Re

- Të vazhdojë organizimin dhe angazhimin e të rinjve në proceset vendimmarrëse, madje edhe me nisma sensibilizuese për të shprehur aktivizmin e tyre dhe gatishmërinë për ta bërë qytetin dhe vendin më të mirë dhe qeverisjen më të përgjegjshme.
- Të vazhdojë lobimin mes qeverisjes vendore dhe komunitetit për të krijuar një urë të re komunikimi dhe bashkëpunimi, në të mirë të një qeverisjeje më të mirë, qyteti më të zhvilluar dhe shoqërie aktive, pjesëmarrëse në proceset vendimmarrëse.
- Të vijojë komunikimet e vazhdueshme dhe nxitjen për veprime konkrete me përfaqësuesit vendor për gjetjen e fondeve të nevojshme për ndërtimin e qendrës psiko – sociale.

Komuniteti

- Komuniteti duhet të ketë një qajse më të mirë ndaj qeverisjes vendore, pasi është e vetmja mënyrë që ata të ndiejnë vlerën e zërit dhe të njohin realisht forcën e tyre.
- Pjesëmarrje në proceset konsultative, hulumtuese, vendimmarrëse, si një nevojë për ta bërë qytetarin të ndihet i vlerësuar, i motivuar për veprimet e të nesërme që do të ndikojnë në jetën e tyre, familjeve të tyre dhe qytetit.
- Ulje e indiferencës ndaj ndërveprimeve institucionale, pasi ato atakojnë direkt ose indirekt në jetën tonë.
- Nxitje e njohjes së nismave dhe procedurave të reja që ndërmerr qeverisja për të evituar sorollatjet e kota në dyert e institucioneve.
- Të hapur ndaj çdo procesi mendimmarrës, duke e parë si një mundësi për të thënë mendimin qytetar në të mirë të së nesërme.


Anekse

Aneks 1- Referenca

- Faqja zyrtare e Bashkisë Fier <https://bashkiafier.gov.al/>
- FB Bashkia Fier <https://www.facebook.com/bashkia.efierit/>
- <https://bashkiafier.gov.al/njoftime/>
- <https://bashkiafier.gov.al/programi-i-transparences/>
- <https://bashkiafier.gov.al/buxheti/>
- <https://bashkiafier.gov.al/Paketa%20fiskale/>
- <https://bashkiafier.gov.al/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve/>
- <https://bashkiafier.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/PT-Adresa-e-Kordinatorit.pdf>
- <https://bashkiafier.gov.al/wp-content/uploads/2023/10/PT-Adresa-e-Kordinatorit-per-konsultim-publik.pdf>
- Faqja e Këshillit të Bashkisë Fier <https://bashkiafier.gov.al/keshilli-bashkiak/>
- FB e Këshillit të Bashkisë Fier <https://www.facebook.com/pages/category/Not-a-Business/K%C3%ABshilli-Bashkiak-Fier-104337948185698/>
- Kontrata Sociale <https://popnetëork.al/raporti-nje-vjecar-kontrata-sociale-bashkia-fier/>
- Kontrata Sociale Fier viti I parë I monitorimit <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-fier-permbushja-e-prioriteteve-viti-i-pare-i-monitorimit/>
- Raporti studimor mbi pjesëmarrjen dhe angazhimin qytetar në nivel vendor <https://popnetwork.al/raporti-studimor-pjesemarrja-dhe-angazhimi-qytetar-ne-nivel-vendor-fier/>
- <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-grate-banore-te-bashkise-fier/>
- <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-te-rinjte-fier/>
- <https://popnetwork.al/fokus-grup-me-perfaqesues-te-mediave-fier/>
- Vendimet e KB Fier <https://popnetwork.al/shkurt-21-vendimet-e-keshillit-bashkiak-fier/>
- Prezantimi I Kontratës Sociale <https://popnetwork.al/prezantimi-i-raportit-nje-vjecar-kontrata-sociale-pop-bashkia-fier/>
- Takime me komunitetin <https://popnetwork.al/takime-me-komunitetin-e-bashkise-fier/>
- Forumi public <https://popnetwork.al/forumi-publik-pop-2019-fier/>
- Raportimbi Covid-19, Bashkia Fier [Raporti_Bashkia Fier_COVID-19](https://popnetwork.al/fier_raporti-i-trete-monitorues-i-kontrates-sociale-shtator-2021-shtator-2022/)
- https://popnetwork.al/fier_raporti-i-trete-monitorues-i-kontrates-sociale-shtator-2021-shtator-2022/
- <https://popnetwork.al/tryeze-diskutimi-me-perfaqesues-te-bashkise-fier-raporti-i-monitorimit-te-kontrates-sociale/>

Aneks 2- Foto


Disa nga aktivitetet dhe punët e bëra prej qendrës “Epoka e Re” në kuadër të projektit POP, Kontrata Sociale 2019.

























56



Aneksi 3 - Kontrata Sociale

